




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštita Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. 61/12
Datë: 04.05.2012

Në mbështetje të nenit 3 paragrafi 1,2 nenit 5 si dhe nenit 49 paragrafi 1.5 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Zv. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror i Agjencisë mori këtë:

V E N D I M

1. Këshillohet "KTV" që gjate transmetimit të xhirimeve të deputetëve në hapësirat e brendshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës mos të mundësoj indetifikimin e numrit apo personit i cili tenton të thërras deputetin.
2. Agjencia të lajmërohet me shkrim brenda pesëmbëdhjete (15) ditëve lidhur me marrjen e masave për zbatimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Në emisionin "Interaktiv" të datës 11.05.2012 në ora 00:16 është transmetuar video-xhirimi i z. [REDACTED] Deputet i Kuvendit të Republikës të Kosovës në kohën kur pranon një telefonat, video-xhirimi i transmetuar mundëson indetifikimin e numrit i cili në ato momentet thërret deputetin në fjale.

Ky transmetim bie ndesh me dispozitat e paragrafi 1 dhe 2 të nenit 3 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Sipas dispozitave të cekura të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë të ligjshme dhe të mos tejkalojnë qëllimet e përpunimit të saj. Mundësia e indetifikimit të numrit të telefonit ka bërë **zbulimin e komunikimit telefonik të [REDACTED]** Deputet i Republikës të Kosovës. Ky zbulim **ka cenuar fshehtësinë e komunikimit të [REDACTED]** garantuar me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 36 të Kushtetutës të Republikës e Kosovës, dhe kjo e drejt mund të kufizohet përkohësisht vetëm në bazë të një vendimi gjyqësor sipas dispozitave të paragrafit 3 të nenit 36.


Video-xhirimet brenda hapësirës të Kuvendit të Republikës të Kosovës nuk kanë, apo nuk duhet të kenë si qëllim zbulimin e komunikimit telefonik të Deputetëve/teve të Republikës të Kosovës. Në rastet kur transmetimet televizive do të mundësojnë indetifikimin e numrit apo personit gjatë komunikimeve telefonike, atëherë ato transmetime do të kenë tejkalim të qëllimit për të cilin mediet janë të pranishme në hapësirat e brendshme të Kuvendit të Republikës të Kosovës.

Duhet theksuar gjithashtu se në bazë të dispozitave të nenit 5 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë përpunimit të të dhënave personale të subjekteve dhe publikimit të tyre paraprakisht duhet që subjektet të japin pëlqimin e tyre .Në rastet kur mediet dëshirojnë të bëjnë publike të dhëna e personave respektivisht bëjnë përpunimin dhe transmetimin e te dhënave personale të deputetëve/teve paraprakisht duhet të kenë pëlqimin e tyre.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Zv. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror


Mentor Hoxhaj

Vendimi i dërgohet:

- KTV
- ██████████ Deputet i Parlamentit të Republikës të Kosovës
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë